



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 09-6590/1 të datës 13.12.2021, të parashtruar nga një parashtrues i njohur kundër më shumë personave të punësuar në -----, HIDHET POSHTË.

Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit konstatoi se për lëndën në fjalë me të njëjtat pretendime tashmë ka vepruar, pas së cilës është miratuar vendimi në seancën e 51-të, të mbajtur më datë 31.08.2021. Gjithashtu, në denoncim nuk ka pretendime të qarta për veprime jo ligjore të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 09-6590/1 të datës 13.12.2021 u formua pas denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i njohur kundër më shumë personave, të punësuar në ----- me pretendime se personi ----- anë tar i komisionin për prokurime publike gjithashtu është edhe anë tarë i Këshillit të shkollës së latëpërmendurë. Personi ----- dy muaj nuk ishte në punë, pas së cilës drejtoresha e së njëjtës shkolle e lejoi atë të merrte pjesë në një ekspozitë artistike që ai vetë e organizoi, por që nuk e përfaqësonte shkollën. Gjithashtu në denoncim është përmendur edhe për uniformat e blera në mënyrë të paligjshme për stafin mësimor.

Në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike për rastin konkret dhe vërtetimin e pretendimeve nga denoncimi, KSHPK-ja realizoi kontroll në evidencat e sajë të denoncimeve të dorëzuara, pas së cilës konstatoi se denoncimi me të njëjtat pretendime tashmë ishte dorëzuar në KSHPK dhe është marrë Vendim me numër 06.09.2021 të datës 06.09.2021

Përkatësishtë, në lidhje me mungesën e punonjësit -----, organi kompetent për veprim është Inspektorati Shtetëror i Arsimit, i cili në objektin e përmendur më parë ka konstatuar tashmë se personi ishte i munguar nga puna për shkak të pjesëmarrjes në një projekt të organizuar nga Qeveria e RMV-së.

Në lidhje me pretendimet kundër personit zyrtarë ----- anëtarë në Këshillin e shkollës në ----- dhe anëtarë në Komisionin për prokurime publike në të njëjtën shkollë, KSHPK konstatoi se nuk bëhet fjalë për shkelje të dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Në përputhje me nenin 89-a të Ligjit për arsimin e mesëm, ku parashikohen kompetencat e Këshillit shkollor të shkollave të mesme komunale, mund të përcaktohet se ky këshill nuk ka kompetencë për të zbatuar, as për të miratuar kontrata publike për nevojat e -----, prandaj personi zyrtar ----- nuk mund të gjendet në gjendje të konfliktit të interesave nëse është edhe anëtar i Komisionit të prokurimit publik. Gjithashtu anëtarësimi në këtë lloj komisionesh nuk përbën kryerjen e një funksioni dhe për këtë arsye nuk janë shkelur as dispozitat e LPKKI-së ku parashikohen kufizimet për kryerjen e aktiviteteve shtesë.

Në seancën e mbajtur më datë 29.07.2022 pas shqyrtimit të të gjithë pretendimeve, KSHPK-ja duke u nisur nga dispozitat e ligjit të parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit, të hidhet poshtë denoncimi për përcaktimin e konfliktit të interesit kundër më shumë personave të punësuar në -----.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Nënkryetar,  
Nuri Bajrami

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së  
Përgatiti: K.Z., Udhëheqës  
Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së